

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 312 Rep.

Nr. 85 Kol.

12



KONTRATË SHITJEJE KUOTASH

Sot në datë 12 .02.2019, para meje Noteres së Dhomës së Noterisë Tiranë, Irma Broci, me studio në Rrugën Don Bosko, lidhet kjo kontratë shitjeje kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

PALA SHITËSE: 1. Zoti MARJAN QAFA, atësia *Ndrec* lindur në Fushe Arrez, Puke më 05.05.1978 e banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. H80505115Q me nr. personal **H80329138H**, ortak i shoqërisë "EUROCOMPANY" sh.p.k (Kodi NUIS L81415013B), me seli Rruga Don Bosko kompleksi Nord Konstruksion Godina 1 Zyra 4, që merr pjesë në shoqëri me 40 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë;

PALA BLERËSE: 2. Zoti ARIAN TUKU, shtetas shqiptar, atësia *ZEF*, lindur më 02.02.1988 në Troshan Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 025110522 me nr. personal I80202037R, ortak i shoqërisë "EUROCOMPANY" sh.p.k (Kodi NUIS L81415013B), Rruga Don Bosko kompleksi Nord Konstruksion Godina 1 Zyra 4, që merr pjesë në shoqëri me 60 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë

OBJEKTI I KONTRATËS: Shitje e 1 kuote e barazvlefshme me 40 % të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "EUROCOMPANY" sh.p.k (Kodi NUIS L81415013B)

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 705 e vijues), Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Nga deklaratimet e palëve të mësipërme dhe nga dokumentet e paraqitura rrjedh se:

a) **Zoti MARJAN QAFA** është ortak i shoqërisë "EUROCOMPANY" sh.p.k, me seli Rruga Don Bosko kompleksi Nord Konstruksion Godina 1 Zyra Kodi tatimor NUIS L81415013B, e regjistruar pranë QKB (*Qendresa Kombëtare të Biznesit*), me kapital të shoqërisë prej **40.000,00** (dyzetemijë) lekë. Në këtë kapital ai zotëron 1 (një) pjesë dhe 40 (dyzete) % të kapitalit të shoqërisë;

b) **zoti MARJAN QAFA** deklaron se 1 kuotë të tij në shoqëri (e që përbëjnë një pjesë dhe 40 % të kapitalit të shoqërisë) ai ka ndër mend t'i shesë;

c) **Zoti ARIAN TUKU** ka shprehur dëshirën e tij dhe pranon të blejë kuotën që shet zoti **MARJAN QAFA**;

d) Shoqëria nuk ka ortak tjetër që të ketë të drejtë parablerjeje të kuotave që shet zoti **MARJAN QAFA**;

e) sipas konfirmimit të marrë nga RBS (*Regjistri i Barrëve Siguruese*), konfirmim që i bashkëlidhet kësaj kontrate, rrjedh se shoqëria nuk ka barrë hipotekore;

f) Ky veprim i shitblerjes së kuotave është miratuar nga asambleja e ortakëve të shoqërisë me vendimin përkatës.

Sot ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, të dy palët deklarojnë se zoti MARJAN QAFJA shtet dhe zoti ARIAN TUKU blen nga zoti MARJAN QAFJA të 1 kuotë e barazvlefshme me 40 % të kapitalit në shoqëri e që deri tani i zotëronte zoti MARJAN QAFJA . Kuotat shiten dhe blihen me çmim sa vlera nominale e tyre, e konkretisht me çmimin total 40.000 (Dyzetëmijë) lekë, shumë e cila është likuiduar tërësisht jashtë kësaj zyre noteriale: zoti MARJAN QAFJA është paguar nga pala blerëse për vlerën e kuotave që shiten dhe nuk ka asnjë pretendim për këtë veprim.

Zoti ARIAN TUKU deklaron se është njohur me aktet e shoqërisë dhe me gjendjen ekonomike e financiare të saj dhe deklaron se si ortak i shoqërisë përgjigjet sipas ligjit për të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve lidhur me këtë kalim pronësie, përfshirë dhe detyrimet e mëparshme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitblerjeje para meje Noteres, Pala Shitëse e humbet 40 % mbi ato kuota që shiti në kapitalin e shoqërisë "EUROCOMPANY " sh.p.k. dhe zotërues i 100 % të tyre bëhet zoti ARIAN TUKU me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ky kalim pronësie.

Kuotat blihen e zotërohen nga Blerësi që nga data e sotme.

Pas këtij akti shitblerjeje kuotash, shoqëria e lartpërmendur ka 1 (nje) ortakë dhe pikërisht:


Zotin ARIAN TUKU , që në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 100 (njqind) % të kapitalit të shoqërisë.

Kjo Kontratë redaktohet në 4 (katër) kopje të barazvlerëshme, ku njëra kopje mbahet nga unë Noterja dhe tri kopjet e tjera u jepen palëve.


Kontrata redaktohet konform neneve 162, 761 e vijues të Kodit Civil, konform ligjit "Mbi Noterinë", konform Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe konform vullnetit të lirë e të plotë të palëve, të cilët, pasi e lexuan përmbajtjen e saj dhe e gjetën atë sipas dëshirës së tyre, e nënshkruajnë atë para meje Noteres pa asnjë vërejtje dhe unë noterja e nënshkruaj rregullisht këtë akt. Bashkëlidhur kësaj kontrate janë dokumentet përkatëse ligjore.

PALËT KONTRAKTUESE

**PALA SHITËSE
MARJAN QAFJA**



**PALA BLERËSE
ARIAN TUKU**



**NOTERE
IRMA BROCI**





OKB

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

Numri unik i identifikimit të subjektit (NUTS)	L81415013B	
Data e Regjistrimit	15/02/2018	
Emri i Subjektit	EUROCOMPANY	
Forma ligjore	SHPK	
Data e themelimit	10/02/2018	
Kohëzgjatja	Nga: 10/02/2018	
Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Don Bosko, kompleksi Konstruksion, zona kadastrale 8340, godina I, zyra 4	
Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
Objekti i aktivitetit	Import eksport dhe tregtimi e mallrave të ndryshë shtesice dhe pakice, transport mallrash për vetite dhe tjetër brenda dhe jashtë vendit, transport vullnetarësh dhe jashtë vendit	
Administratori të	Artan Tuku	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 10/02/2018	Deri: 10/02/2018
Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
Ortakët	Marjan Qafa	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 40.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	40,00	
<i>te përfunduarit, (Plotësohet vetëm nëse tërion kuotën si përfunduar)</i>		
Ortakët	Artan Tuku	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 60.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	60,00	



OKB

<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kështu si përfaqësues)</i>	
14. Vende të tjera të udhëzuara të aktivitetit	
15. Të dhëna që njohohen vullnetarisht	Emri Tregtar: EUROCOMPANY Telefon: 0682075507
16. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:
Dokumentet e autorizimit
Statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshëm nga akti i themelimit)
Mandati bankar ose vleratimi i pasuritë për pagimin e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)

Regjistrimi Filestar:

Date: 15/02/2018

Emri, Mbiemri, Nënkriani
(i nëpunësit të specialit)

Kopje nga Web

VENDIMI ASAMBLESË SË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "EUROCOMPANY" sh.p.k

Kodi NUIS L81415013B

Nr. 1 datë 31.01.2019

Sot më datën 31.01.2019 në selinë e shoqërisë në Tiranë, në adresën Rruga Don Bosko kompleksi Nord Godina 1 zyra 4, u mbledh Asambleja e Ortakëve të shoqërisë shqiptare "EUROCOMPANY" sh.p.k (Kodi NUIS L81415013B). Në këtë mbledhje të Asamblesë mori pjesë ortaku i vetëm :

1. **MARJAN QAFA**, atësia *Ndrec* lindur në Fushe Arrez, Puke më 05.05.1978 e banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. H80505115Q me nr. personal **H80329138H**, ortak i shoqërisë "EUROCOMPANY" sh.p.k (Kodi NUIS L81415013B), me seli Rruga Don Bosko kompleksi Nord Konstruksion Godina 1 Zyra 4, që merr pjesë në shoqëri me 40 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë

2. **ARIAN TUKU**, shtetas shqiptar, atësia *ZEF*, lindur më 02.02.1988 në Troshan Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 025110522 me nr. personal I80202037R, ortak i shoqërisë "EUROCOMPANY" sh.p.k (Kodi NUIS L81415013B), Rruga Don Bosko kompleksi Nord Konstruksion Godina 1 Zyra 4, që merr pjesë në shoqëri me 60 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë

Asambleja është mbledhur për të vendosur sipas këtij rendi dite:

RENDI I DITËS

1. Shitja e 1 kuote e barazvlefshme me 40 % të kapitalit dhe blerja e kësaj kuote nga Arian Tuku.
2. Të ndryshme dhe të mundshme.

* * * * *

Drejtimin e asamblesë e merr z. Arian Tuku, i cili, pasi vuri re :

- që në mbledhje është përfaqësuar i gjithë kapitali i shoqërisë, nga që janë të pranishëm të gjithë ortakët që zotërojnë 100 % të kuotave,
 - që të gjithë folësit u shprehën se ishin vënë në dijeni për çështjet e vëna në rendin e ditës dhe se janë dakord që t'i shqyrtojnë ato,
- në bazë të statutit e shpall mbledhjen e sotme të kushtetuar rregullisht dhe me fuqi të plota e të aftë për të marrë vendime.

Duke patur parasysh se:

- Ortaku **Marian Qafa** zotëron 40 % të kuotave të shoqërisë dhe ai dëshëron të shesë 40 % të kuotës ;
- **Arian Tuku** ka shprehur interesin për t'i blerë për veten e vet 40 % të kuotës që shet zoti **Marjan Qafa** ;
- shoqëria nuk ka ortakë të tjerë;
- dhe ky veprim nuk bie ndesh me Statutin e shoqërisë dhe as me legjislacionin në fuqi;

Duke u patur parasysh të gjitha këto, Asambleja e ortakëve

VENDOS

- a) të miratojë shitjen e 1 kuote të shoqërisë që është në pronësi të zotit **Marjan Qafa** , e që janë baraz me 40 % të kuotave (*kapitalit*) të shoqërisë,
- b) të miratojë blerjen nga ana e zotit **Arian Tuku** të kuotës të shoqërisë që shet zoti **Marjan Qafa** ,
- d) çmimi i shit-blerjes së kuotave do të jetë i barabartë me vlerën nominale të tyre dhe modalitetet e pagesës do të përcaktohen nga palët e interesuara;
- e) të depozitohet ky vendim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Pas këtij veprimi shit-blerjeje kuotash, shoqëria "EUROCOMPANY " sh.p.k. do të ketë 1 ortak :

- a) Zotin ARIAN TUKU , që në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 100 (njqind) % të kapitalit të shoqërisë.


Duke mos pasur gjë tjetër për të vendosur, Asambleja mbyllet në orën 13:00, pasi u redaktua, u lexua, u miratua dhe u nënshkrua ky Vendim i shoqërisë "EUROCOMPANY " sh.p.k.

U lexua, u miratua dhe u nënshkrua.

Tiranë, më 31.01.2019

ORTAKET

MARJAN QAFJA



ARIAN TUKU



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-201902129585573
Data e Rezultatit të Kerkimit: 12.02.2019
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 9:58:05AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-162-1193
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERMIMI 0

EUROCOMPANY SH.P.K.



Anna Doku